

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Monitorimi

Strategjia për Zhvillim Institucional 2013 – 2017

Korrik 2017

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Qëllimi	4
Forma raportimit.....	4
Periudha e raportimit dhe afati kohor i raportimit	5
Procedurat e përgatitjes së raportit	5
Përshkrimi i implementimit të objektivave të Strategjisë.....	5
Nën-objektivi 1.1: Lobim që amendimet e ligjit të miratohen në Kuvend.....	7
Nën-Objektivi 1.2: Rregullat e brendshme do të duhet të zhvillohen në disa fusha	7
Nën objektivi 1.3 Intensifikimi i komunikimit me Kuvendin e Shqipërisë.....	8
Objektivi Nr. 2: Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit.....	9
Nën-Objektivi 2.1: Modernizimi i qasjes së auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë	9
Nën-Objektivi 2.2: Zhvillimi i kompetencave dhe të kapaciteteve të auditimit financiar	10
Nën-Objektivi 2.3: Zhvillimi i auditimit të integritetit.....	10
Nën-Objektivi 2.4: Zhvillimi i auditimit të menaxhimit të fondeve të BE.....	11
Nën-Objektivi 2.5 Programimi i auditimit bazuar në rrezik.....	11
Nën-Objektivi 2.6 Zhvillimi i udhëzimeve të materialeve specifike të auditimit.....	12
Nën-Objektivi 2.7 Forcimi i rolit të Departamentit të Politikave të Auditimit për hartimin e metodologjive dhe aktiviteteve të lidhura të trajnimit.....	13
Nën-Objektivi 2.8: Zhvillimi i trajnimeve profesionale.....	14
Nën-Objektivi 2.9: Zhvillimi i kontrollit të cilësisë në auditim.....	15
Nën-Objektivi 2.10 “Pjesëmarrje aktive e KLSH ne programin“3i”	17
Objektivi Nr. 3. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditime vetë performancës...17	
Nën objektivi 3.1 Funkzioni auditues.....	18
Nën objektivi 3.2 Palët e interesit.....	19
Nën objektivi 3.3 Kapacitetet njerëzore institucionale	19
Nën objektivi 3.4 Kapacitetet njerëzore individuale	19
Objektivi Nr. 4. Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim.....	20
Nën-Objektivi 4.1: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të TI.....	20
Nën-Objektivi 4.2: Zhvillimi i auditimit TI	21
Objektivi Nr. 5. Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.....	21
Objektivi Nr. 6 Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit.....	23
Konkluzione	25
Matrica e monitorimit.....	28

1. HYRJJE

Kontrolli Larte i Shtetit luan një rol qendror ndërmjet institucioneve publike të auditimit dhe sfidat në rritje dhe sofistikimi i mjediseve në të cilat vepron, e bën gjithnjë e më të rëndësishëm forcimin e kapaciteteve institucionale të tij.

KLSH duhet të përmbushë standardet më të larta për të siguruar transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e operacioneve qeveritare, një detyrë kjo që cilësohet me nivel të rëndësishëm kombëtare. Prandaj, ky Institucion duhet të identifikojë dhe modelojë faktorët kritikë për suksesin në forcimin e funksionit të auditimit të qeverisjes. Qëllimi është arritja e rezultateve të qëndrueshme dhe progresive në nivelet taktike dhe strategjike dhe përqendrimi në përpjekjet për përmirësimin e legjislacionit, metodologjisë dhe praktikës së auditimit.

Për shkak të rolit të tij, KLSH mundet dhe duhet të ndihmojë për të identifikuar fushat e zhvillimit të ardhshëm në sistemet e auditimit publik të vendit, të cilat mund të adresohen duke bashkëpunuar me organet shtetërore të përfshira dhe duke zbatuar koncepte afatgjata të zhvillimit.

Të gjitha institucionet që përbëjnë një sistem publik të auditimit publik duhet të punojnë së bashku për të identifikuar dhe përcaktuar në një rrugë zhvillimi që do të çojë në përmirësimin e qeverisjes, të sigurojë transparencën dhe llogaridhënien e sektorit publik, parandalimin e mashtrimit, abuzimit dhe korrupsionit si dhe të plotësojë kërkesat për përdorimin efikas të burimeve publike.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka formalizuar misionin, vizionin dhe vlerat në vitin 2013 në Planin Strategjik të Zhvillimit 2013-2017. Procesi reformës institucionale i nisur që në fillim të vitit 2012, solli ndryshime rrënjësore të cilat u reflektuan në mënyrën organizimit, funksionimit dhe forcimin e rolit të institucionit më të lartë auditues publik në Shqipëri. Miratimi i Ligjit 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” u hapi rrugën zhvillimit dhe rritjes së Institucionit, duke Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke e vendosur në krye të radhës së institucioneve publike më të vlerësuara nga organizmat ndërkombëtare.

Efektet e ndryshimeve krijuan njëkohësisht domosdoshmërinë e rishikimit të Strategjisë së Zhvillimit, për periudhën 2015-2017, duke pasqyruar jo vetëm ndryshimet e ndodhura prej periudhës së fillimit të planifikimit strategjik e deri në momentin e rishikimit e cila do të synonte të sillte në fokus vizionin strategjik, dhe afatgjatë të menaxhimit largpamës të institucionit për periudhën e ardhme

E mbështetur fuqimisht në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Strategjia e Zhvillimit orienton veprimtarinë e KLSH drejt zhvillimeve që do ta vendosin këtë institucion në krah të institucioneve homologe të vendeve të zhvilluar të Rajonit dhe duke synuar më tej, të vendoset shumë pranë të SAI- ve të vendeve anëtare të BE-së të konsideruar si praktikatat më të mira të zhvillimit.

Me gjithë arritjet , disa çështje sistemore ende duhet të adresohen, duke përfshirë mangësitë në organizimin e sistemeve të auditimit publik dhe shkëmbimit të informacionit, mundësi të kufizuara për të kryer auditime të pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë, dhe veprime parandaluese joefikase dhe mekanizma të paralajmërimit të hershëm të përdorur për të zbuluar shkeljet dhe rastet më të rënda të abuzimeve me detyrat e funksionet shtetërore e fondet publike. Kontrolli i Lartë i Shtetit, anëtar i Organizatave Ndërkombëtare dhe Evropiane të Institucioneve

Supreme të Auditimit INTOSAI dhe EUROSAI-t, udhëhiqet fuqimisht nga drejtimet strategjike të veprimtarisë së këtyre organizmave dhe të cilat reflektohen në Strategjinë e Zhvillimit të tij.

Ajo është në koherencë me aspiratat e shoqërisë sonë për përafrim me praktikat evropiane dhe normat *acquis communautaire* të BE-së. Realizimi i plan veprimeve të strategjisë është shoqëruar me procese gjithëpërfshirëse të stafit menaxherial dhe operacional auditues, duke promovuar diskutimin dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje.

2. QËLLIMI

Menaxhimi i ndryshimit kërkon një rivlerësim të vazhdueshëm, duke përditësuar, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet e objektivave apo nën objektivave të vendosura për periudhën strategjike me fokus në pritshmëritë e së ardhmes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit planifikon veprimtarinë e tij mbi bazën e Planit Strategjik disa vjeçar (3-5 vjet), ku përcaktohen prioritetet për zhvillim të periudhës strategjike në drejtim të përbushjes së qëllimeve dhe arritjes së objektivave strategjike të institucionit. Planifikimi strategjik monitorohet në vijimësi, për sa i përket ecurisë gjatë zbatimit dhe rishikohet çdo vit.

Qëllimi i Raportimit Vjetor të Monitorimit të PSZH, 2013 -2017 të rishikuar, është të monitorojë progresin e bërë kundrejt objektivave të vendosur në planifikim si dhe të monitorojë efektivitetin e politikave të vendosura nëpër arritjen e vizionit dhe misionit të caktuar në Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH.

Raporti i Monitorimit rivlerëson nivelin e përbushjes së indikatorëve të vendosur në Planin e Veprimit si në aspekte të përmbajtjes ashtu dhe kohës së realizimit të tyre.

Raporti i Monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të KLSH, 2013-2017, i rishikuar jep një pamje të situatës aktuale të zhvillimit dhe arritjeve të deritanishme të institucionit dhe do të shërbejë si bazë për përgatitjen dhe hartimin e zhvillimeve strategjike për periudhën e ardhshme. Në mënyrë më specifike Raporti i Monitorimit PSZH do të shërbejë për:

- Si udhërrëfyes për procesin e vendimmarrjes menaxheriale;
- Vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe strategjive të përfshira; dhe
- Matjen e ndryshimeve të rëndësishme në ambientin e veprimtarisë së KLSH.

Monitorimi ofron informacion të dobishëm për të gjithë palët e interesit si : publiku i gjerë, parlamenti dhe komisionet përkatëse, po ashtu dhe organizma të tjerë ndërkombëtare si Komisioni Evropian, SIGMA e organizata profesionale e institucione homologe ndërkombëtare, veprimtaria e të cilave është e lidhur ngushtësisht me KLSH .

3. FORMA E RAPORTIMIT

Raporti Monitorimit të PZHS të KLSH, është ndërtuar në dy pjesë duke përfshirë: pjesën përkrahëse ku analizohet statusi i implementimit të secilit objektiv, nën-objektiv dhe element specifik, si dhe pjesën tabelore përmbledhëse me një funksion të ndërlidhur ndërmjet objektivave dhe/ose nën objektivave, veprimtarive, indikatorëve dhe statusin e implementimit. Në matricë evidentohen strukturat zbatuese, afatet e zbatimit, aktori i zbatimit, jepet informacioni se kush janë treguesit e suksesit dhe monitorimit si dhe statusi i implementimit.

4. PERIUDHA E RAPORTIMIT DHE AFATI KOHOR I RAPORTIMIT

Monitorimi është një proces periodik. Monitorimi i implementimit të objektivave reflekton punën e bërë deri në këtë moment të veprimtarisë dhe periudha e raportimit fillon nga është nga momenti i miratimit të strategjisë nga Kryetari.

Raporti i Monitorimit fokusohet në informacione që i përkasin periudhë 12 mujore 1 korrik 2016 deri më 30 Qershor 2017. Përmbajtja e Raportit është hartuar në përputhje me politikat dhe kuadrin ligjor aktual, Standardet e Auditimit dhe Rregullave mbi të cilat KLSH ushtron veprimtarinë.

5. PROCEDURAT E PËRGATITJES SE RAPORTIT

Ky dokument është hartuar në bazë të Urdhrit nr. 42 të Kryetarit të KLSH-së për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së, 2015 – 2017, e ripunuar, Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit Administrativ të KLSH dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH. Kërkesat e akteve të mësipërme përcaktojnë detyrimin e KLSH për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme implementimin e Planit Strategjik të Zhvillimit, për të siguruar koherencë të informimit dhe arritjen e masave në kohë për të përmirësuar situatën nëse është e nevojshme. Një herë në vit përgatitet Raporti i Monitorimit të PLSZH, me qëllim raportimin në kohë të masës së realizimit të objektivave strategjike institucionale, përditësimin e tij në raport të përshtatshëm me zhvillimet aktuale dhe për të rritur sigurinë së institucioni po vepron në përputhje me kërkesat dhe objektivat e vendosura në Planin Strategjik të Zhvillimit të KLSH.

Drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm dhe mbështetur nga Drejtori i Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoritë e KLSH-së sipas fushave të auditimit ky Raport Monitorimi i paraqitet Kryetarit të KLSH dhe miratohet me vendim të posaçëm prej tij.

6. PËRSHKRIMI I IMPLEMENTIMIT TË OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË

Mandati, Misioni, Vizioni dhe Vlerat i Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë përcaktuar dimensionet e shtrirjes së zhvillimeve strategjike të institucionit të cilat kanë realizuar vlerat e institucionit. Analiza e mjedisit strategjik në aspekte të pikave të forta dhe mundësive të para në këndvështrimin e kufizimeve të dobësive dhe kërcënimeve kanë bërë të mundur që KLSH të vendosë objektiva strategjike për periudhën 2015 -2017.

Në përcaktimin e tyre, KLSH është frymëzuar nga katër objektivat themelore të Strategjisë së Zhvillimit 2011-2017 të EUROSAT, të cilat janë:

1. Ngritja e kapaciteteve;
2. Standardet profesionale
3. Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës; dhe
4. Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe efektive të komunikimit

OBJEKTIVI NR. 1. ZHVILLIMI I KAPACITETIT INSTITUCIONAL TË KLSH. AMENDIMI I BAZËS RREGULLATORE TË KLSH-SË NË PËRPTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË AUDITIMIT DHE PRAKTIKAT E MIRA EVROPIANE

Kontrolli i Lartë i Shtetit- ALSAI si një anëtar i INTOSAI-t, gjatë viteve, dhe në mënyre të dukshme në pesë vjetarin e fundit ka miratuar një vizion afatgjatë zhvillimi për sistemin e auditimit shtetëror.

Aktivitetet zbatuese janë hartuar për të adresuar problemet sistemore dhe për të vendosur prioritetet përfshirë forcimin e pavarësisë të auditimit të jashtëm publik dhe sigurimin e përmirësimit të qëndrueshëm të kapaciteteve të tij në përputhje me shembujt e suksesshëm të organeve publike.

Së bashku me iniciativat për krijimin dhe zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe rregullatorë, KLSH ka ndërmarrë dhe realizuar iniciativa konkrete në hartimin akteve legjislative që rregullojnë dhe lidhen me auditimin publik. Në nivelin metodologjik, KLSH është përqendruar në forcimin e zhvillimit institucional duke harmonizuar veprimtarinë e tij me ISSAI dhe standardet e tjera profesionale të fushës së auditimit. Harmonizimi parashikon përmirësimin e cilësisë së standardeve që do të përmbushin nevojat e audituesve dhe do të sigurojë auditim të përshtatshëm dhe efektiv. Duke përmirësuar mënyrën se si veprimtaria audituese strukturohet dhe implementohet e udhëhequr nga standardet dhe praktikat më të mira të profesionit auditues, KLSH ndihmon në sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies më të mirë të organeve ekzekutive dhe ndihmon në parandalimin e shkeljeve dhe mashtrimit, duke rritur kështu nivelin e besimit të publikut në qeverisjen publike.

Kontrollin e Lartë të Shtetit synon të rrisë besimin tek puna e produktet e tij, duke ruajtur “me fanatizëm” parimet e pavarësisë, etikës, profesionalizmit, hapjes dhe shërbimit të interesit publik.

KLSH në veprimtarinë e saj të auditimit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në kuadrin legjislativ të Shtetit Shqiptar dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të pranuar INTOSAI-t (ISSAI). Zhvillimi institucional i referohet forcimit të kapaciteteve institucionale, duke u bërë një institucion model i qeverisjes së mirë në sektorin publik. KLSH synon të krijojë një model të qeverisjes së mirë brenda institucionit, nëpërmjet rritjes së transparencës së veprimtarisë së saj, pjesëmarrjen e palëve të interesuara, përdorimin ekonomik dhe efikas të burimeve, promovimin e përgjegjësisë individuale dhe institucionale, krijimin e një kulturës së pa tolerueshme për konfliktin e interesit, parregullsi dhe mashtrimit. Ky objektivi është detajuar në tre nën objektiva ai i lobimit që amendimet e ligjit të miratohen në Kuvend dhe në vijimësi të tij përpilimi i rregullimeve të brendshme si dhe intensifikimi i marrëdhënieve më Kuvendin.

Objektivi strategjik i zhvillimit të kapaciteteve institucionale të KLSH nëpërmjet amendimit dhe përsosjes të bazës rregullatorë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane është detajuar në tre nën objektiva:

- 1.1) Lobimi mbi amendimet e ligjit për miratimin në Kuvend dhe në vijimësi të tij
- 1.2) Hartimi dhe përmirësimi i rregulloreve, manualeve dhe udhëzimeve specifike
- 1.3) Intensifikimi i marrëdhënieve me Kuvendin.

Nën-objektivi 1.1: Lobim që amendimet e ligjit të miratohen në Kuvend

Miratimi i Ligjit 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” shënoi një kthesë të rëndësishme në zhvillimin institucional të KLSH dhe mundësoi t’i hapet rrugë jetësimit të reformave thelbësore në fushën e auditimit të jashtëm publik në Shqipëri.

Ligji organik i KLSH i mbështetur fuqishëm nga partnerët evropianë si Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit në Komisionin Evropian dhe SIGMA/OECD, ofron bazat që KLSH si institucion i auditimit publik të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si dhe praktikave më të mira të profesionit mbarë botërorë.

Statusi i implementimit : Realizuar

Nën-Objektivi 1.2: Rregullat e brendshme do të duhet të zhvillohen në disa fusha

Krijimi dhe zhvillimi i konceptit të ri të auditimit publik, vuri në dukje domosdoshmërinë e ridimensionimit dhe përshtatjes së kuadrit tërësor rregullator e organizativ mbi bazën e të cilit organizohet dhe zhvillohet veprimtaria e Institucionit më të Lartë Shtetëror të Auditimit.

I hartuar në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtarë të fushës së auditimit të jashtëm publik, Ligji për Kontrollin e Lartë të Shtetit shtroi themelet mbi bazën e të cilave do të ndërtohej korniza rregullatorë e proceduralë e funksionimit të institucionit, përfshirë dimensionet metodologjike e organizative.

Prej fillim vitit 2015, janë hartuar e miratuar akte nënligjore, rregullat të brendshme të organizimit, manuale e udhëzues procedural për auditimin mbi bazën e të cilave është organizuar dhe vijon të kryhet veprimtaria institucionale në përgjithësi.

Ky dimension përfshin përmbushjen e aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit 2013 – 2017, të rishikuar të konkretizuar në hartimin dhe miratimin e dokumenteve sa më poshtë:

1.2.1. - Hartimi i Kodit të përditësuar të Etikës dhe rregullave të sjelljes - Vendim i Kryetarit të KLSH, Nr. 56, datë 30.04.2015 “Për miratimin e Kodit Etik të KLSH-së”;

Statusi i implementimit : Realizuar

1.2.2. - Strategjia e Menaxhimit Riskut të KLSH-së 2015-2017 dhe regjistri i Riskut – Vendim i Kryetarit Nr. 41, datë 30.03.2015 “Për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut për KLSH”;

Statusi i implementimit : Realizuar

1.2.3. - Rishikimi i Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së - Vendim i Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30/06/2015 për “Rregulloren e brendshme të organizimit dhe Funksionimit të KLSH-së”;

Statusi i implementimit : Realizuar

1.2.4 - Rishikimi i strukturës organizative dhe hartimi i përgjegjësive të njëjësive organizative në KLSH – me anë të Vendimit nr. 7, datë 03.02.2016 të Kryetarit të KLSH, “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH”, i ndryshuar është miratuar struktura organike me një total prej 176 punonjësish.

Statusi i implementimit : Realizuar

1.2.5 - Hartimi i rregullave dhe procedurave për certifikimin e stafit të auditimit – Si pjesë e rëndësishme e Strategjisë së Burimeve Njerëzore, zhvillimi profesional i audituesve mbetet në fokus të reformimit institucional. Që prej vitit 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka krijuar një sistem të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional të Audituesve. Sistemi përfshin identifikimin dhe vlerësimin periodik të nevojave për trajnim, dhe hartimin dhe miratimin e përvitshëm të Programit Vjetor të Trajnimit dhe Zhvillimit Profesional të Stafit të KLSH. Udhëzuesi për procedurat e reja të certifikimit dhe 1.2.6 - Rregullat e procedurave për certifikimin e stafit të auditimit janë në proces përgatitje.

Statusi i implementimit : Në proces -Rivendosje e afatit të plotësimit – Mars 2018

1.2.7.- Hartimi i dokumentit të politikave të burimeve njerëzore dhe zbatimi i tij - Mbështetur në një analizë të politikave ekzistuese aktuale të KLSH në fushën e burimeve njerëzore dhe në kuadër të aktiviteteve të parashikuara nën Projektin IPA 2013, “ Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm” gjatë vitit 2016 e në vijim janë realizuar misione të ekspertëve polakë në bashkëpunim me specialistët shqiptarë të KLSH për rishikimin e politikave aktuale të burimeve njerëzore dhe përcaktimi i përmbajtjes së politikave për to". Dokumenti i Politikave përfshin 10 dimensionet e mëposhtme: 1. Rekrutimi, 2. Periudha e provës, 3. Trajnimi dhe zhvillimi, 4. Promovimi, 5. Motivimi dhe shpërblimi, 6. Përfshirja dhe pjesëmarrja, 7. Relacionet e punonjësve, 8. Kushtet e punës, 9. Balanca punë-jetë, 10. Disiplina

Dokumenti Politika e Burimeve Njerëzore unifikon në një dokument të vetëm objektivat më të rëndësishme të KLSH në lidhje me menaxhimin e kapitalit njerëzor. Kjo politikë përfaqëson iniciativën e për përmirësim, modernizim dhe krijimin një qasje të re të menaxhimit të burimeve njerëzore në KLSH. Ky aktivitet është integruar nën produktet për t'u realizuar me mbështetjen e Projektit të binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian, IPA 2013 dhe konkretisht në aktivitetet numër 3.1.2, 3.1.3 dhe 3.1.4.

Statusi implementimit : Draft Dokumenti Politika e Burimeve Njerëzore në Kontrollin e Lartë të Shtetit për miratim nga Kryetari i KSLH;

1.2.8. - Akti nënligjor : “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, kontraktimit dhe pagesës së ekspertëve të jashtëm të KLSH-se”. –Vendim i Kryetarit të KLSH nr. 61, dt. 09.05.2015 “Për rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes, të kontraktimit dhe të pagesës së ekspertëve të përkohshëm të jashtëm të KLSH”, botuar në fletoren zyrtare nr. 76, viti 2015.

Statusi i implementimit : Realizuar

Nën objektivi 1.3 Intensifikimi i komunikimit me Kuvendin e Shqipërisë

Në zbatim të planit të Zhvillimit Strategjik të Institucionit dhe me mbështetjen e projektit IPA të BE-së, KLSH do të ripunojë strategjinë e tij të komunikimit për të qenë sa më pranë Kuvendit, publikut dhe medias, duke sjellë vazhdimisht ide të reja, të cilat janë domosdoshmëri për të qenë inovative, atraktive dhe në koherencë me ndryshimet e shpejta të TI.

Institucioni ka realizuar një prezencë më të madhe në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, duke rritur nivelin e transparencës dhe përgjegjshmërisë përpara parlamentit dhe deputetëve. Janë intensifikuar marrëdhëniet jo vetëm në nivel mbledhjesh për raportim institucionit, por është rritur pjesëmarrja e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë në aktivitete të organizuara nga KLSH, të tilla si Konferenca Shkencore, Tryeza diskutimi, takime me vlerësues dhe ekspertë nga Institucionet Ndërkombëtare dhe homologët etj.

Gjatë periudhës së këtij monitorimi, është realizuar aktiviteti “Organizimi i një seminari për marrëdhëniet me Parlamentin”. Në Nëntor 2016 në bashkëpunim me ekspertët Polak është organizuar një seminar ku janë analizuar rregullorja dhe praktikrat që KLSH ka aplikuar në marrëdhëniet me Parlamentin. Në konkluzion është krijuar një udhëzues mbi institucionalizimin e marrëdhënieve me Parlamentin. “Hartimi i Strategjisë së Komunikimit” tashme është përfunduar dhe është në proces miratimi nga Kryetari i KLSH Në Tetor 2016 në bashkëpunim me ekspertët Polak është zhvilluar një dokument mbi strategjinë e Komunikimit. Ky dokument nuk është finalizuar, pasi është në proces të rishikimit dhe miratimit final nga Kryetari i KLSH-së. Ky aktivitet është integruar me Projektin e binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian, IPA 2013.

Statusi i implementimit : Realizuar

OBJEKTIVI NR. 2: RRRITJA E KAPACITETEVE AUDITUESE DHE E CILËSISË SË AUDITIMIT

Praktikat e mira të fushës kërkojnë që zhvillimi metodologjik dhe profesional i burimeve njerëzore të kryhet bazuar në dy shtylla kryesore: 1) krijimin e një profili të lartë profesional të audituesit shtetëror dhe 2) sigurimin e kryerjes së veprimtarisë audituese në përputhje të plotë me standardet e auditimit të jashtëm publik si dhe praktikrat e mira të fushës të konkretizuara në manualin e auditimit, rregullore të procedurave të auditimit, përmirësimin e raportimit dhe transparencës si dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit auditues.

Nën-objektivat e detajuara të këtij objekti përfshijnë (2.1) Modernizimin e qasjes së auditimit të përputhshmërisë, (2.2) Zhvillimin e auditimit financiar dhe të kapaciteteve audituese, (2.3) Zhvillimin e auditimit të integritetit, (2.4) Zhvillimin e auditimit të menaxhimit të fondeve të BE-së, (2.5) Programin e auditimit të bazuar në risk, (2.6) Zhvillimin e udhëzimeve dhe materialeve specifike të auditimit, (2.7) Forcimin e rolit të departamentit të politikave të auditimit për hartimin e metodologjive dhe aktiviteteve të lidhura të trajnimit, (2.8) Mbi zhvillimin e trajnimeve profesionale, (2.9) Mbi zhvillimin e kontrollit dhe të cilësisë në auditim si dhe (2.10) Mbi pjesëmarrjen aktive të KLSH-së në programin “3i”.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe në vijim

Nën-Objekti 2.1: Modernizimi i qasjes së auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë

Hartimi dhe miratimi i Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë vendosi bazat për të sjellë qasjen e këtij lloji auditimi në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Vendimi i Kryetarit nr. 196, datë 29.12.2015 “Mbi miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe financiar”, bëri të mundur që të iniciohen auditimet pilot, mbështetur në implementimin e këtyre Manualeve. Për të vlerësuar shkallën e pajtueshmërisë së Manualeve me Standardet ISSAI, SIGMA ka dhënë komentet përkatëse të cilat së bashku me vlerësimin e kryerjes së auditimeve pilot do të jenë kriteret mbi të cilat do të rishikohen duke reflektuar gjithashtu edhe zhvillimet më të fundit të ambientit të jashtëm institucional.

Në funksion të indikatorit të performancës trajnimi i stafit ka realizuar mbulimin tërësor të audituesve me standardet e auditimit ISSAI si dhe Manualin e Auditimit duke i dedikuar një vend të veçantë manualit të auditimit të përputhshmërisë.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe në vijim

Nën-Objektivi 2.2: Zhvillimi i kompetencave dhe të kapaciteteve të auditimit financiar

Referuar realizimit të nën-objektivit 2.1, sa më sipër Vendimi i Kryetarit nr. 196, datë 29.12.2015 ka shënuar miratimin e Manualit e Auditimit Financiar. Krahas aktiviteteve trajnuese të cilat kanë patur si “Target Group” stafin e dedikuar për kryerjen e auditimeve financiare, kryerja e auditimeve pilot bazuar në aplikimin e parimeve dhe kërkesave të Manualit të Auditimit Financiar do të përcaktojnë fushat të cilat do të rishikohen dhe përmirësohen. Në përputhje me rekomandimet për përmirësim nga SIGMA, Manuali Auditimit Financiar, do të rishikohet ai duke reflektuar gjithashtu edhe zhvillimet më të fundit të standardeve të këtij lloj auditimi.

Ligji organik vendos para KLSH obligimin për dhënien e një opinioni mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar dhe dhënien e opinionëve mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara. Kjo parashtron rishikimin e Manualit e Auditimit Financiar, duke përfshirë edhe udhëzime mbi opinionet e auditimit dhe të raportimit si dhe trajnimin e audituesve financiarë.

KLSH ka realizuar mbulimin tërësor me trajnim të audituesve sipas standardeve të auditimit financiar, ISSAI si dhe Manualet e Auditimit duke i dedikuar një sesion të veçantë Manualit e Auditimit Financiar.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe ne vijim

Nën-Objektivi 2.3: Zhvillimi i auditimit të integritetit (kundër mashtrimit dhe korrupsionit)

Auditimi i integritetit, si risi viteve të fundit, është përqsur dhe nxitur fuqishëm për t'u implementuar gjithnjë e më shumë në SAI-t e zhvilluara dhe në komunitetin INTOSAI.

KLSH në tagrin e të qenit anëtare e Grupit të Punës së INTOSAI për auditimin e integritetit angazhohet në të ardhmen në realizimin dhe shtimin e numrit të auditimeve të integritetit. Në kuadrin e aktiviteteve të parashikuara nën këtë Strategji përshihet zhvillimi i Manualit të Auditimit referuar çështjeve kundër mashtrimit dhe korrupsionit i cili do të mbështetet në vijimësi me trajnime të stafit në këtë fushë me rëndësi të veçantë në kuadrin e gjerë të misionit të auditimit shtetëror si “wachdog” i fondeve publike e interesave të taksapaguesve shqiptarë.

Gjatë periudhës së monitorimit të kësaj Strategjie, KLSH ka ndërmarrë një seri iniciativash domethënëse në mbështetje të luftës kundër korrupsionit shtetëror, rezultatet e të cilave e kanë vendosur atë në qendër të aktoreve kryesorë të kësaj beteje ndaj fenomenit sa të papranueshëm aq dhe të dëmshëm për shoqërinë.

Mbështetja me asistencë teknike nga Projekti IPA 2013, ka siguruar përgatitjen e një Draft Manualin e Auditimit të Integritetit në njësitë e sektorit publik, i cili pas miratimit përfundimtar nga Kryetari i KLSH do të vijohet me trajnimet për stafin e përzgjedhur nga audituesit më të aftë në drejtim të rritjes së kapaciteteve për realizimin e këtij auditimi, si një veprimtari që rrit përgjegjshmërinë në administrimin e fondeve publike dhe parandalon ose kufizon mashtrimin financiar dhe korrupsionin në njësitë që auditohen.

Aktiviteti 2.3.1 “Zhvillimi manualit të auditimit referuar çështjeve kundër mashtrimit dhe korrupsionit” është realizuar në Dhjetor 2016 në bashkëpunim me ekspertët nga NIK- u Polak në varësi të të cilit do të jetë dhe arritshmëria e aktivitetit 2.3.2 “Mbi trajnimin e stafit për implementimin e manualit të mashtrimit dhe korrupsionit” .

Statusi i implementimit : Realizuar dhe ne vijim

Nën-Objektivi 2.4: Zhvillimi i auditimit të menaxhimit të fondeve të BE

Në sfidën e procesit të anëtarësimit, mbështetja nga ndihma financiare e BE-së për Shqipërinë është intensifikuar, me qëllim avancimin e reformave dhe lehtësimin e investimeve relevante për procesin e anëtarësimit, si edhe kontributin në zhvillimin socio-ekonomik të saj. Reformat institucionale dhe legislative, si dhe investimet në zhvillimin e infrastrukturës, kërkojnë burime shumë më të mëdha sesa buxheti kombëtar i Shqipërisë, e cila sigurohet ndër të tjera me anë të asistencës teknike nën IPA.

Instrumenti i Asistencës së Para- anëtarësimit (IPA) është mjeti me të cilin BE-ja mbështet reformat në ‘vendet e zgjerimit’ me anë të ndihmës financiare dhe teknike. E përgatitur në partneritet me vendet përfituese, IPA I dhe IPA II, përcaktojnë kornizën për dhënien e ndihmës së para-anëtarësimit për periudhën 2007 – 2013 dhe 2014-2020.

Përdorimi me efektivitet i fondeve të mbështetjes së financiare me anë të IPA , mbart me vete sfida të rëndësishme që lihen me mënyrën se si dhe për çfarë përdoren këto fonde. Auditimi i Projekteve të Financuara nga BE luan një rol të rëndësishëm në mbajtjen të përgjegjshëm dhe llogaridhënien e përdorimit të këtyre financimeve për të dy palët, Shtetin Shqiptar si përfitues i Asistencës Teknike dhe Komisionit të Bashkimit Evropian si donatori kryesor i këtij procesi.

Për këtë arsye, auditimet e Projekteve të financuara nga BE, përbëjnë një fokus të veçantë për Kontrollin e Lartë të Shtetit. Kryerja e këtyre auditimeve, kërkon njëkohësisht adoptimin e metodologjive dhe qasjeve të auditimit në pajtueshmëri me kërkesat e Komisionit për IPA të pasqyruara në Marrëveshjet Kuadër midis KE-së dhe vendit përfitues si dhe të detajuara në dokumente udhëzues , Rregullore e Direktiva të KE-së.

Në përgjigje të kësaj nevojë KLSH ka filluar “Zhvillimin e metodologjisë për auditimin e fondeve të BE-së” dhe mbi këtë bazë kryerjen e trajnimit të stafit auditues për këtë kategori auditimi të cilat do të ndikojnë pozitivisht në krijimin dhe formimin e kapaciteteve audituese të pajisur me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme.

Krahas trajnimeve specifike për këtë temë nga eksperte të SAI-ve partnere të KLSH si dhe ekspertë lokalë, trajnimet dhe shkëmbimeve të eksperiencës së ngjashme në vendet përfituese të ndihmës së BE do të jenë aktivitete që pritet të japin efektet pozitive në pasurimin dhe zgjerimin e njohurive të audituesve në këtë fushë.

Nën Objektivi parashikohet të arrihet nëpërmjet realizimit të tre aktiviteteve përkatësisht 2.4.1, 2.4.2 dhe 2.4.3 për të cilat statusi i implementimit është ende në proces.

Statusi i implementimit : Në proces

Nën-Objektivi 2.5 Programimi i auditimit bazuar në risk

Qëllimi i auditimit mbi bazë risku është të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e auditimeve duke ndryshuar në mënyrë rrënjësore praktikën audituese. Standardet ndërkombëtare të auditimit lidhur me vlerësimin e riskut ofrojnë rregulla në një numër të konsiderueshëm fushash përfshirë vlerësimin e riskut të qenësishëm dhe riskut të kontrollit si dhe lidhjet midis këtyre vlerësimeve të riskut dhe procedurave të mëtejshme të auditimit.

Pa mundësia në termat e kohës, burimeve njerëzore dhe financiare për të realizuar auditime tërësore të çdo leku të fondeve publike të përdorur ka sjelle përdorimin e teorive propabilitare në fushën e auditimit. Zhvillimet në profesionin e auditimit, ambientin ku ky profesion ushtrohet po sjell gjithnjë e më shumë kërkesën për rritje të efektivitetit të auditimit duke fokusuar përpjekjet e ISA në aplikimin e standardeve të cilat sigurojnë një proces më të besueshëm auditimi.

Planifikimi i auditimit është një fushë vitale e procesit auditues dhe ndihmon për të siguruar që fushave më të rëndësishme u është kushtuar vëmendje e veçantë, që problemet e mundshme janë identifikuar në kohë dhe menjëherë, dhe që puna është koordinuar dhe realizuar sipas pritshmërive. "Planifikimi i auditimit" nënkupton zhvillimin e një strategjie të përgjithshme dhe një qasje të detajuar për natyrën, kohën dhe shtrirjen e auditimit.

Për këtë qëllim, me Vendim nr. 41 dt 30.03.2015, të Kryetarit, "Për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut për KLSH-në", u miratua dokumenti që përcakton përjasjen me risk në planifikim të programit vjetor të auditimit. KLSH do të përgatisë programin e saj vjetor të auditimeve të bazuar në një analizë të rrezikut të subjekteve të audituara.

Udhëzuesi i veçantë për programin vjetor të auditimit numër 4, datë 31.12.2015, reflekton qartë metodologjinë e përjasjes me risk në planifikim. Pjesë e këtij procesi është edhe përditësimi i regjistrit të riskut institucional, që kryhet në baza vjetore. Në kuadrin e projektit IPA është realizuar plani vjetor i auditimit për vitin 2017.

I mbështetur nga tre aktivitetet kryesore përkatësisht 2.5.1, 2.5.2 dhe 2.5.3. nën objektivi përfshin "*Hartimin e plotë i programit vjetor të auditimit sipas modelit të bazuar në risk*" të realizuar në bashkëpunim me ekspertët e IPA në Qershor 2016. Në periudhën në vijim deri në Qershor 2017 janë zhvilluar "*Prezantimi dhe zhvillimi i metodologjisë lidhur me programimin e auditimit të bazuar në risk*" dhe në Prill 2016 në bashkëpunim me ekspertët Polak, si pjesë e aktivitetit 3.1.1.1 (Projekti IPA'2013) është zhvilluar dhe prezantuar metodologjia lidhur me programimin e auditimit të bazuar në risk. Për këtë, në vijim, nga ekspertët e IPA u asistua në përpilimin e planit të punës audituese për vitin 2017, duke u bazuar në metodologjinë e riskut.

"*Trajnimi i stafit të përzgjedhur lidhur me përdorimin e modelit të riskut në programimin vjetor të auditimit*" është zhvilluar në bashkëpunim me asistencën teknike të Projektit IPA, u zhvillua në Korrik 2016 trajnimi i stafit në lidhje me metodologjinë e përzgjedhjes me risk dhe planifikimin.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe në proces miratimi

Nën-Objektivi 2.6 Zhvillimi i udhëzimeve të materialeve specifike të auditimit

Kuadri specifik metodologjik dhe i procedurave të auditimit përfshin një gamë të gjerë të dokumenteve udhëzues dhe manuale që adresojnë fushat dhe çështjet më të rëndësishme dhe specifike të auditimit.

KLSH nën këndvështrimin e investimit afatgjatë dhe duke synuar të kryejë auditime të mbështetura fuqimisht dhe në pajtueshmëri të plotë me Si pjesë e botimit të manualit të vetë vlerësimit të integritetit për institucionet supreme të auditimit, u përgatit një material në lidhje me menaxhimin e riskut të mashtrimit, promovimit të kulturës kundër mashtrimit si dhe minimizimit të mundësive për ndodhjen e mashtrimit. Gjithashtu pjesë e këtij materiale ishin dhe "korrupsioni dhe integriteti" si dhe "KLSH dhe INTOSAINT: Profili mbi menaxhimin e Sistemit të Kontrollit të Integritetit në KLSH gjatë periudhës 2012 - 2014". Zhvillimi i mëtejshëm në formën e manualit është parashikuar si pjesë e projektit IPA.

Në funksion të udhëzimeve të materialeve specifike të auditimit është realizuar manuali COBIT "Objektivat e informacionit kontrollit të teknologjisë së informacionit" pjesë e planit vjetor të botimeve të vitit 2015. COBIT 4.11, botim i Organizatës ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit, ISACA (Information Systems Audit and Control Association), është një strukturë e përdorur gjerësisht, e cila përmbledh rekomandimet, praktikat

dhe metodat më të mira të vlerësimit për kontrollet e përgjithshme IT, si dhe për programet që zhvillohen në këto ambiente.

Në funksion të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve u përpilua udhëzuesi i miratuar me vendim të Kryetarit numër 3 dt. 03.11.2015, numër 1015 prot. dt. 03.11.2015 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimit e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”,. Ky udhëzim përcjell një metodë të unifikuar të auditimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara në subjektet e audituara, së bashku me raportin përfundimtar të auditimit, në reflektim të kërkesave ligjore të detajuara në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH.

Në funksion të zhvillimi i metodologjive për raportimin e auditimit dhe formulimin e rekomandimeve është duke u rishikuar rregullorja e procedurave të auditimit si dhe të dokumenteve të auditit.

Aktiviteti 2.6.1 “Përcaktimi i rregullave për përgjegjësitë e audituesve gjatë auditimit të mashtrimit financiar dhe integritetit” është zhvilluar pjesërisht. Në Shtator 2016 në bashkëpunim me ekspertët e projektit IPA, pjesë e aktivitetit 2.1.2, u zhvillua trajnimi mbi auditimin e mashtrimit financiar dhe integritetit.

Aktiviteti 2.6.2 “Zhvillimi i metodologjive për raportimin e auditimit dhe formulimin e rekomandimeve” është zhvilluar pjesërisht. Në Maj 2017 në bashkëpunim me ekspertët e projektit IPA, pjesë e aktivitetit 2.2.5, u zhvillua analiza e procesit të auditimit dhe mbi përmirësimet e mundshme për formulimin e rekomandimeve. Në funksion të zhvillimi i metodologjive për raportimin e auditimit dhe formulimin e rekomandimeve është duke u rishikuar rregullorja e procedurave të auditimit si dhe të dokumenteve të auditit.

Aktiviteti 2.6.3 “Sistemi i IT si mbështetje për ndjekjen e konkluzioneve të auditimeve si dhe zbatimit të rekomandimeve” nuk ka nisur. Në bashkëpunim me ekspertët e projektit IPA në aktivitetin 1.2.3 është parashikuar për t’u zhvilluar brenda **Marsit 2018**.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe në proces

Nën-Objektivi 2.7 Forcimi i rolit të Departamentit të Politikave të Auditimit për hartimin e metodologjive dhe aktiviteve të lidhura të trajnimit

Zhvillimi i kapaciteteve të KLSH, si një nga qëllimet strategjike të periudhës synon formimin e një trupe profesionale audituese dhe mbulon dy drejtimet kryesore: zhvillimin e metodologjive mbi të cilat do të mbështetet puna audituese dhe zhvillimin profesional të audituesve. Objektivat ambicioze për kryerjen e auditimeve cilësorë dhe në pajtueshmëri me Standardet ISSAI nuk mund të arrihen nëse nuk sigurohet më parë një mbështetje metodologjike nëpërmjet manualeve dhe udhëzuesve për kryerjen e veprimtarisë audituese sipas llojeve dhe specifikave të auditimeve. Përkthimeve dhe botimeve të disa prej udhëzuesve që lidhen me ISSAI specifike i bashkëngjiten dhe manualët e Auditimit Financiar, Auditimit të Pajtueshmërisë, Auditimit të Performancës dhe të Auditimit të TI-së, tashmë të hartuara. Ato gjithashtu janë mbështetur me një sërë udhëzuesish praktikë dhe instruksione për kryerjen e veprimtarive specifike.

Megjithatë KLSH e konsideron thelbësore forcimin e lidhjes midis funksionit metodologjik me trajnimet, ku këto të fundit do të zhvillohen apo përzgjidhen mbi bazën e zhvillimeve metodologjike nga praktikrat e mira të SAI-ve partnere të KLSH dhe nga aktivitetet e IDI, EUROSAI dhe INTOSAI si dhe projektin IPA.

Tashmë janë në dispozicion Standardet e Auditimit të INTOSAI, ISSAI 5220, Udhëzime mbi praktikrat më të mira të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve & Kodi i Transparencës Fiskale, FMN, Standardet e Auditimit të Qeverisë, Manuali i Auditimit Financiar, Manuali i Auditimit të

Përputhshmërisë, Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët të Performancës, Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, COBIT Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit, Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes-ECA, ISSAI 30-Kodi i Etikës, Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik, Udhëzues për Auditimin e Mjedisit, Rregullorja e Brendshme, Udhëzues mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimit e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Përfitimi nga eksperiencia e përbashkët në formën e pjesëmarrjes në workshop-e, monitorim të plotë të rezultateve, raporteve dhe rekomandimeve të kongreseve, konferencave dhe seminareve të zhvilluara nga INTOSAI dhe EUROSAI për përcjelljen pranë audituesve të KLSH të trendeve të reja të auditimit publik suprem në botë, kryerja e auditimeve paralele kanë qenë pjesë e veprimtarisë së vitit 2016 e në vijim.

KLSH ka konsideruar gjithnjë rëndësinë e faktorëve të tillë si statusi dhe struktura e organizimit, mënyra se si udhëhiqet dhe drejtohet, burimet në dispozicion dhe shpërndarja efektive e tyre ndikojnë në mënyrë thelbësore në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të tij. Për këtë qëllim, filozofia e drejtimit përfshin aplikimin e qasjeve më efektive për të siguruar shfrytëzimin e të gjitha sinergjive të strukturave e cila është konkretizuar në Strukturën Organizative të KLSH, Janar 2017.

Kjo ka përfshirë riorganizimin e disa prej njësive organizative përfshirë rishikimin e funksioneve dhe përgjegjësi në një nivel më të lartë.

Departamenti i Politikave të Auditimit është riorganizuar duke u fokusuar në dy drejtimet kryesore që synojnë krijimin dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe institucionit mbi baza të qëndrueshme. Drejtoria e Metodologjisë është shndërruar në Departamentin e Metodologjisë dhe Strategjisë së Auditimit duke theksuar fokusin strategjik të drejtimit dhe mbështetjen në metodologjitë dhe standardet e profesionit.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe në proces

Nën-Objektivi 2.8: Zhvillimi i trajnimeve profesionale

Aplikimi i procesit të trajnimit në KLSH është tashmë i zhvilluar dhe me një eksperiencë disa vjeçare. Për këtë zhvillim i kërkesave të mësipërme mund të konsiderohet një proces i konsoliduar.

Bazuar në objektivin e Strategjisë për Zhvillim, 2015-2017, dhe në Programin Vjetor të Trajnimeve, gjatë vitit 2016 janë zhvilluar gjithsej:

- 3,702 ditë trajnimi për punonjësit dhe
- 342 ditë trajnimi nga stafi menaxherial për audituesit.

Në total ditët e trajnimit të zhvilluara në vitin 2016 janë 4,044.

Ditë Trajnimi realizuar vetëm për stafin auditues janë 3,702 ditë trajnimi, me një mesatare prej 27 ditë trajnimi për auditues.

Duke e grupuar në kategori trajnimet janë fokusuar në drejtimet:

- e trajnimeve në fushën e metodologjisë audituese
- trajnime në fushën e kuadrit rregullator dhe funksional të subjekteve që auditohen
- të tjera ku kemi përfshirë trajnimet nga konferencat, workshop-et dhe vizitat studimore

Objektivat ambicioze për kryerjen e auditimeve cilësore dhe në pajtueshmëri me Standardet ISSAI nuk mund të arrihen nëse nuk sigurohet më parë një mbështetje metodologjike nëpërmjet manualeve dhe udhëzuesve për kryerjen e veprimtarisë audituese sipas llojeve dhe specifikave të

auditimeve. Përkthimeve dhe botimeve të disa prej udhëzuesve që lidhen me ISSAI specifike i bashkëngjiten dhe manualët e Auditimit Financiar, Auditimit të Pajtueshmërisë, Auditimit të Performancës dhe të Auditimit të TI-së, tashmë të hartuara.

Ato gjithashtu do të pasurohen me një sërë udhëzuesish praktikë dhe instruksione për kryerjen e veprimtarive specifike. Sidoqoftë një lidhje më e fortë pritet të ndërtohet midis funksionit metodologjik me trajnimet, ku këto të fundit do të zhvillohen apo përzgjidhen mbi bazën e zhvillimeve metodologjike nga praktikatat e mira të SAI-ve partnere të KLSH dhe nga aktivitetet e IDI, EUROSAI dhe INTOSAI si dhe projektin IPA. Tashmë janë në dispozicion Standardet e Auditimit të INTOSAI, ISSAI 5220, Udhëzime mbi praktikatat më të mira të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve & Kodi i Transparencës Fiskale, FMN, Standardet e Auditimit të Qeverisë, Manuali i auditimit Financiar, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët të Performancës, Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, COBIT Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit, Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes-ECA, ISSAI 30-Kodi i Etikës, Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik, Udhëzues për Auditimin e Mjedisit, Rregullorja e Brendshme, Udhëzues mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimit e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Përfitimi nga eksperiencia e përbashkët në formën e pjesëmarrjes në workshop-e, monitorim të plotë të rezolutave, raporteve dhe rekomandimeve të kongreseve, konferencave dhe seminareve të zhvilluara nga INTOSAI dhe EUROSAI për përcjelljen pranë audituesve të KLSH të trendeve të reja të auditimit publik suprem në botë, kryerja e auditimeve paralele kanë qenë pjesë e veprimtarisë së vitit 2015 e në vijim.

Kapacitetet audituese të stafit të KLSH-se do të forcohen kryesisht nëpërmjet rritjes së njohurive individuale të stafit nën kuadrin e zhvillimit profesional institucional. Ky proces do të kontribuojë në krijimin e një trupe profesionale audituesish, të aftë të përballojnë misionin e institucionit dhe të realizojnë vizionin nëpërmjet kryerjes së auditimeve profesionale. Procesi kërkon hartimin e miratimit të rregullave e procedurave të veçanta për realizimin e tij, në mënyrë të drejtë dhe transparente. Ai mund të kërkojë riklasifikimin e pozicioneve të audituesve në përputhje me njohuritë që priten të fitojnë audituesit.

KLSH do të përqendrohet në përcaktimin e njohurive të audituesve sipas llojeve të auditimit, si një çështje që kërkon një vëmendje të veçantë dhe është pjesë e vlerësimeve dhe analizave paraprake në përputhje me misionin e institucionit. Institucioni do të hartojë me kujdes modulet e trajnimit, do të kryejë përzgjedhjen e trajnerëve, mbi bazën e një bashkëpunimi efektiv me qarqet akademike, me ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike), IEKA, KKK, etj. Përvetësimi i njohurive më të përparuara mbi auditimin do të kryhet duke përdorur edhe mjete të tilla si auditimet pilot për çështje që janë me tipike ose paraqesin risi (p.sh. auditimi Teknologjisë së Informacionit) apo për subjekte komplekse. Transmetimi i përvojës së fituar nëpërmjet këtyre auditimeve do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të workshop-eve dhe seminareve njohës me stafin, si dhe nëpërmjet publikimit të tyre në faqen e internetit.

KLSH do të vijojë të ruajë rezultatet e arritura nga implementimi i Programit të Zhvillimit të Vijueshëm të Trajnimit duke iu referuar treguesve prej 25 ditë trajnimi në vit për audituesit me eksperiencë dhe mbi 30 ditë trajnimi në vit për të rinjtë. Institucioni do të vijojë me trajnimin e burimeve njerëzore me të gjithë elementet e saj, ku do të përfshihet rritja e profesionalizmit të stafit përmes studimeve pasuniversitare në nivel masteri apo doktore, ndjekjes së studimeve universitare në degë të dyta, përmirësimin e nivelit dhe zgjerimit të audituesve që njohin gjuhën e huaj dhe shfrytëzimin e materialeve dhe studimeve në gjuhë të huaj. Krahas çështjeve të trajtuara më sipër, KLSH do të institucionalizojë përfundimisht politikatat e reja të rekrutimit dhe

të zhvillimit të burimeve njerëzore, të zbatuara me intensitet gjatë tre viteve të fundit si dhe në respekt të faktorëve të tjerë të mjedisit strategjik të KLSH-se, të cilët kërkojnë me përparësi sigurimin e burimeve njerëzore dhe financiare të institucionit për zhvillimin e trajnimeve. Ky proces trajnimi zhvillohet duke bërë analizë të burimeve njerëzore, duke angazhuar burime të brendshme dhe të jashtme si dhe përmes angazhimit në procese të rishikimit të jashtëm dhe të brendshëm. Sidoqoftë, duke bashkëpunuar me ekspertët Polak dhe Kroat, në kuadër të projektit IPA po zhvillohet më tej metodologjia e analizimit të nevojave për trajnim si dhe e vetë strukturimit të procesit të trajnimit.

Statusi i implementimit : Realizuar dhe në proces

Nën-Objektivi 2.9: Zhvillimi i kontrollit të cilësisë në auditim

Kontrolli i Lartë i Shtetit e konsideron cilësinë e auditimit si jetike për kryerjen e misionit të tij, për imazhin dhe besueshmërinë e institucionit të publiku dhe Kuvendi. Për këtë, institucioni do të përmirësojë skemën për menaxhimin e cilësisë, e cila përfshin shqyrtimet në të ftohtë dhe në të nxehtë. Tashmë është krijuar Kjo skemë e përmirësuar do të ketë ndikim të padiskutueshëm në rezultatet e auditimit dhe në kapacitetin institucional, si dhe do t'u japë një rol më të madh niveleve përkatëse menaxheriale të auditimit, duke u shoqëruar me përgjegjësitë e tyre për produktet e auditimit.

Skema duhet të kombinojë rolin e menaxhereve me pavarësinë e audituesve në dhënien e opinionëve, duke e ruajtur thellësisht atë, por duke forcuar paralelisht edhe përgjegjësitë e audituesve për besueshmërinë e raporteve të prodhuara prej tyre. Kjo skemë do të përfshijë më dukshëm procesin e menaxhimit të cilësisë së auditimit në të gjitha fazat e auditimit, që nga programi i auditimit deri të ekzaminimi dhe raportimi. Ajo do të japë sigurinë e plotë të vendim-marrësve mbi besueshmërinë e raporteve të auditimit. Për këtë, grupe pune *ad hoc* do të kompletojnë një raport vjetor mbi cilësinë e auditimeve të kryera, si dhe ekspertë të jashtëm do të pajtohen për të vlerësuar cilësinë e auditimeve të kryera.

Udhëzimi numër 2 datë 30.12.2016 ka ardhur si një përmirësim i udhëzimit të vitit 2012 për të promovuar dhe mbështetur zhvillimit profesional dhe individual të audituesve të KLSH-së. Qëllimi i këtij udhëzuesi është forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit të KLSH-së, duke orientuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të audituesit.

Udhëzimi është zhvilluar në funksion të promovimit të zhvillimit profesional. Si i tillë më shumë se sa një Udhëzim, që synon të promovojë zhvillimin profesional i audituesve të KLSH-së, ai është një normë që tregon për përgjegjshmërinë që ndejmë Ne, ndaj qytetarit dhe shoqërisë, pjesë e përpjekjeve tona për të bërë ndryshimin në jetën e gjithsecilit. Orientimet e këtij udhëzimi synojnë të krijojnë një atmosferë, ku kërkesa e llogarisë për vete dhe për kolegun, nxit frymën e bashkëpunimit dhe të përgjegjshmërisë. Përpjekjet e institucionale të KLSH-së për të aplikuar standardet e auditimit dhe praktikat e mira audituese duhet të shoqërohen me këtë frymë zhvillimi individual.

Krahas sa me sipër janë zhvilluar procese të pikasura zhvillimore:

- ✓ *Monitorimi i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut.*
- ✓ *Monitorimi i Strategjisë së Zhvillimit, 2013-2017, e rishikuar.*

- ✓ *Monitorimi i Strategjisë së Implementimit të Standardeve të auditimit ISSAI.*
- ✓ *Përmirësimi i manualeve të auditimit.*

Në kuadër të projektit IPA, në bashkëpunim me ekspertët e NIK-ut Polak, ekspertët e SAI-t Kroat dhe ekspertët lokal të KLSH-së, në vitin 2016, u realizuan një sërë aktivitetesh zhvillimore të metodologjisë dhe të praktikave të punës, duke përfutur konkluzione në formë rekomandimesh, të cilat do të kthehen në objektiva dhe plan veprimesh. Në mënyrë të shkurtuar evidentojmë:

Në bashkëpunim me ekspertët Polak, Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit dhe Drejtuesve të Departamenteve/ Drejtorive, në kuadër të projektit IPA, u zhvillua përmirësimi i metodologjisë së planifikimit vjetor të auditimeve. Objektivi i kësaj praktike ishte që nëpërmjet konsultimit, diskutimit, hartimit të rekomandimeve, vlerësimit të riskut të sigurohen ndryshime pozitive në planifikim.

Nën objektivi 2.9 përbëhet nga tre aktivitete, përkatësisht 2.9.1, 2.9.2 dhe 2.9.3. Nga këto aktivitete të realizuara në periudhën deri në Qershor Aktiviteti 2.9.2 “*Zhvillimi i metodologjisë së kontrollit dhe sigurimit të cilësisë dhe përmirësimi i skemës së sigurimit të cilësisë*” është realizuar duke prodhuar një draft dokument. Në Korrik 2016 në bashkëpunim me ekspertët Polak është zhvilluar dokumenti mbi kontrollin dhe sigurimin e cilësisë. Ky dokument nuk është finalizuar, pasi është në proces të rishikimit dhe miratimit final nga Kryetari i KLSH-së. Ky aktivitet është integruar me Projektin e binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian, IPA 2013 dhe konkretisht në aktivitetet numër 2.5.1.

Statusi i implementimit : Realizuar në vijimësi

Nën-Objektivi 2.10 “Pjesëmarrje aktive e KLSH ne programin “3i””.

KLSH ka nënshkruar Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të IDI dhe EUROSAI për Programin “3i”, Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve.

IDI (Instituti i Zhvillimit Ndërkombëtar i INTOSAI) ka zhvilluar Programin e quajtur “3 i-të”, i cili nënkupton Nismën e Implementimit të standardeve ISSAI. Në kuadër të këtij programi, vendet anëtare të IDI, pjesë e të cilit është dhe Shqipëria, angazhohen për të hartuar Strategji, të cilat sigurojnë jo vetëm përshtatjen e Standardeve ISSAI, por mbi të gjitha pajtueshmërinë në implementimin e tyre. Kjo marrëveshje nënkupton angazhimin e tre palëve SAI-t, IDI dhe EUROSAI për implementimin e ISSAI-ve në nivel kombëtar, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të Strategjisë për implementim.

E angazhuar për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja KLSH ka përbushur tashmë të tre veprimtaritë atë të përcaktimit të rolit dhe përgjegjësisë të Moderatorëve, të cilët do të udhëheqin procesin e implementimit të ISSAI – ve në nivel kombëtar, atë të kryerjes së vlerësimeve mbi pajtueshmërinë e ISSAI-ve, me ndihmën e Moderatorëve të ISSAI, si dhe atë të hartimit të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve, duke përfshirë gjetjet e “iCAT-s” (Mjetet e Vlerësimit të Pajtueshmërisë me ISSAI-t) dhe hartimin e një Plani Veprimi për implementimin e Strategjisë.

Nën objektivi 2.10 përbëhet nga dy aktivitete, përkatësisht 2.10.1 dhe 2.10.2.

Hartimi i strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve, (aktiviteti 2.10.1) duke përfshirë gjetjet e “iCAT-s” (Mjetet e Vlerësimit të Pajtueshmërisë me ISSAI) dhe hartimin e një Plani Veprimi për implementimin e Strategjisë është realizuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr 58, dt 30.06.2015.

Aktiviteti 2.10.2 “Organizimi i një Seminari rajonal (duke ftuar dhe përfaqësues nga SAI-t e tjera të rajonit) lidhur me eksperiencat pozitive nga Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve” nuk është zhvilluar pasi kërkon koordinimin dhe mbështetjen e këtij aktiviteti nga institucione të tjera ndërkombëtare . KLSH është në kërkim të mundësimit të këtij aktiviteti.

Statusi i implementimit : Realizuar pjesërisht .

OBJEKTIVI NR. 3. PËRMIRËSIMI I CILËSISË DHE SHTIMI I NUMRIT TË AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS.

Duke njohur rëndësinë dhe rolin e fuqishëm të auditimit të performancës, këto auditime janë shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni po përballët çdo ditë me një sfidë të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, si një mjet efektiv për vlerësimin e përgjegjshmërisë publike, duke lidhur objektivat strategjike me fondet publike. Përballimi i kësaj sfide përbën një ndërgjegjësim të ri të rolit të KLSH-së në auditimin publik. Realizimi i objektivit të mirë menaxhimit dhe rritjes së vlerës së parasë publike kërkon rritjen e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës nga viti në vit dhe në mënyrë graduale, në përputhje me burimet e krijuara të auditimit

Si pjesë e objektivave të planit strategjik 2013-2017, KLSH gjatë vitit 2016 ka realizuar 13 auditime performance në reformat qeveritare, projektet dhe shërbimet social-ekonomike, projektet infrastrukturore, projektet mjedisore dhe energjitike, si dhe projektet dhe shërbimet social-kulturore. KLSH do zhvillojë më tej auditimin e performancës pikërisht dhe kryesisht në rezultate, më tepër se sa në proces, duke theksuar nevojën për ndryshim, për përmirësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm të menaxhimit publik. Institucioni ka sfidën që të konsiderojë nëse synimet e politikave dhe skemat lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit.

Auditimet e performancës do të vazhdojnë të përqendrohen në marrëveshjet e koncesioneve, sigurinë e konsumatorit, prokurimet publike, performancën e borxhit publik, etj. Zhvillimet e metodologjive specifike që lidhen me auditimin e performancës janë të domosdoshme për realizimin e këtij objektiv. Kjo masë do të zgjidhë procedurat e përzgjedhjes së subjekteve për të kryer një auditim performance, planifikimit të auditimit të performancës, teknikave të auditimit dhe mbledhjes së të dhënave, për të kompletuar auditimet e performancës, si dhe çështje specifike që kanë të bëjnë me objektivat, kontrollin e cilësisë, raportimin dhe rekomandimet e auditimit të performancës.

Hapat që do të ndërmerren në këtë drejtim kanë të bëjnë me krijimin e një skeleti standard për auditimin e performancës, duke synuar përfshirjen në auditim të literaturës bashkëkohore mbi fenomenin apo subjektin që po auditohet, legjislacionin e BE-së në fushën që po auditohet, bazën ligjore vendase, auditimet e kryera nga SAI të tjera të suksesshme, etj. Po kështu, do të synohet aplikimi i metodave shkencore financiare, statistikore dhe ekonometrike për një auditim performance që me të vërtetë ndihmon në përmirësimin e përdorimit të fondeve publike.

Për të realizuar objektivin e mësipërm, Departamenti i Auditimit të Performancës së KLSH, do të përcaktojë çdo vit kriteret në përzgjedhjen e fushave të auditimit. Kriteret e përzgjedhjes do të reflektojnë lidhjen me situatën aktuale të zhvillimit në vend, sfidat e sektorit publik, përmirësimin e treguesve makroekonomikë dhe rritjen e bashkëpunimit me SAI-t e tjerë për të kryer auditime të përbashkëta.

Programe të veçanta trajnimi hartohen dhe zbatohen për të kompletuar njohuritë e stafit në lidhje me auditimin e performancës pjesë e programit vjetor të trajnimeve dhe urdhrave për trajnime specifike si ai zhvilluar në periudhën 25 janar – 5 shkurt 2016, nr 32 dt , dt 07.03.2016 si dhe trajnimet në departament. Njëkohësisht në funksion të këtij zhvillimi gjatë implementimit të Projektit IPA, janë programuar 4 auditime pilot si dhe trajnime e vizita studimore për auditimin e performancës në SAI-t homologe.

Ky objektiv është detajuar në tre nën objektiva ai (3.1) Funksioni auditues, (3.2) Palët e interesit, (3.3) Komunikimi dhe (3.4) Kapacitetet njerëzore. Nën objektivat 3.3 dhe 3.4 janë zhvilluar brenda periudhës Qershor 2016. Nën objektivat 3.1 dhe 3.2 paraqiten si në vijim. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës përbën një nga sfidat më madhore të KLSH-së.

Auditimi i performancës i institucionit për periudhën e ardhshme strategjike do të jetë një veprimtari e konsoliduar, me një vëllim të shumëfishuar të numrit aktual të auditimeve të performancës , me një staf të mirë-trajnuar që ka demonstruar aftësi të spikatura në kryerjen e këtij lloji auditimi me ndikim në administratën publike shqiptare. Auditimi i Performancës do të jetë një nga dy aktivitetet më të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e institucionit.

Nën objektivi 3.1 Funksioni auditues

Nën objektivi 3.1 përbëhet nga gjashtë aktivitetet që përfshijnë:

3.1.1 “Rritja e cilësisë së auditimeve të performancës” Në përputhje me objektivat e strategjisë për zhvillim është zgjeruar stafi auditues i Drejtorisë së Performancës si dhe janë organizuar auditime të përbashkëta mes departamenteve dhe auditime paralele me sai homologë.

3.1.2 “Shtimi i numrit të auditimeve të performancës, duke rritur gradualisht kapacitetet profesionale dhe numerike të departamentit”, Në përputhje me objektivat e strategjisë për zhvillim është zgjeruar stafi auditues i Drejtorisë së Performancës si dhe janë organizuar auditime të përbashkëta mes departamenteve dhe auditime paralele me sai homologë. Gjatë vitit 2015 janë realizuar 12 auditime performance, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016 janë realizuar 2 auditime dhe janë në proces 9.

3.1.3 Rritja e rolit këshillues & rekomandues të auditimeve të performancës ndaj subjekteve të audituara - Zgjerimi i fushës së auditimit, rritja e cilësisë së rekomandimeve dhe zgjerim i gamës së institucioneve të cilat lidhen me problematikën e audituar janë disa nga veprimtaritë e ndërmarra në këtë drejtim

3.1.4 Përgatitja e Manualit të Performancës për KLSH-në.- Miratuar me Vendim nr 47, dt 30.04.2015 Manuali i Auditimit të Performancës

3.1.5 Zhvillimi i metodologjive specifike. Indikatorët e Performancës - Realizuar botimi mbi Indikatorët e Performancës e në vijim do rishikohet nën komponentët e IPA Auditime të ndryshme tematike që prekin spektër të gjerë problemor.

3.1.6 “Unifikimi dhe strukturimi i “letrave të punës” për auditimin e performancës është realizuar.

Nën objektivi 3.2 Palët e interesit

Në funksion të objektivit lidhur me auditimin e performancës , forcimi i bashkëpunimit me mjediset akademike, të ekspertizës dhe shoqërisë civile ka vijuar të jetë në fokus të aktivitetit të KLSH. Këtij qëllimi i kanë shërbyer dhe shtimi i referencave ndaj auditimeve të performancës dhe pjesëmarrjes së ekspertëve të jashtëm, kryerja rregullisht e analizës departamentale dhe institucionale në bashkëpunim me mjediset akademike, lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit e në vijim.

Krahas bashkëpunimit ndërdepartamental, prej vitesh është aplikuar ngritja e grupeve të përbashkëta audituese me SAI-e fqinje për problematika reciproke. Nën këtë ndërveprim janë

realizuar auditim paralel me teme "Burimet alternative të energjisë" (auditim performance), e në vijim auditim paralel me temë "prokurimi publik", i cili drejtohet nga SAI i Suedisë në bashkëpunim me ECA dhe auditimi i koordinuar "Cilësia e ajrit", i cili kryhet nga vendet anëtare të grupit të punës së EUROSAI për auditimet e mjedisit. Gjithashtu në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucionet vendase me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi janë Realizuar workshop auditim paralel performance, Kosovë, Workshop për auditimin e performancës së cilësisë së ajrit, Hagë e në vijim.

Nën objektivi 3.2 vlerësohet i plotësuar në të gjithë aktivitetet e parashikuara për arritjen e tij, ndërkohë që Aktiviteti 3.2.5 "*Parametra të performancës për administratën publike –Referenca të përgjithshme*" nuk është realizuar përfundimisht. Në proces përpunimi është përpilimi i një broshure për subjektet e administratës publike.

Nën objektivi 3.3 Kapacitetet njerëzore institucionale

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore në kuadrin institucional për auditimin e performancës ka vënë në fokus krijimin e një seksioni të veçantë në faqen e WEB-it të KLSH-së për auditimin e performancës. Tashmë Departamenti i Auditimit të Performancë përfaqësohet me një faqe (ëeb site) moderne ku pasqyrohet raporti, info përmbledhëse dhe observacionet e subjektit.

Krijimi i një kanali virtual komunikimi departamental është realizuar nëpërmjet hapjes së një faqeje virtuale në Facebook. Numri gjithnjë e në rritje i shkrimeve në lidhje me KLSH të botuar në median e shkruar janë tregues të veprimtarive konkrete në funksion të objektivit për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore institucionale në tërësi përfshirë dhe at të dedikuar për auditimin e performancës.

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale ka vijuar të realizohet në vijimësi dhe është konsideruar si një mjet i fuqishëm për të siguruar arritjen e objektivave kryesore lidhur me rritjen e numrit dhe cilësisë së auditimeve të performancës.

Nën objektivi 3.4 Kapacitetet njerëzore individuale

Vendimi nr. 7, datë 03.02.2016 i Kryetarit të KLSH, "Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH", i ndryshuar ka prezantuar strukturën e re organike me një total prej 176 punonjësish. Nga viti 2011 dhe 2012 vite në të cilat struktura ka pasur një numër total prej 156 punonjësish ka ardhur duke u rritur me një shtesë prej 5 vendesh në vitin 2013 përkatësisht 161 punonjës, 5 vende për vitin 2014, përkatësisht 166 punonjës, 5 vende për vitin 2015, përkatësisht 171 punonjës dhe 5 vende për vitin 2016, përkatësisht 176 punonjës.

Strategjia e zhvillimit të burimeve njerëzore nëpërmjet rishikimit dhe riorganizimit të strukturimit të punëve dhe funksioneve në KLSH është zbatuar duke adresuar dy drejtimet kryesore: Avancimi në karrierë dhe trajnimin e zhvillimit profesional të audituesve. Kjo skemë i ofron rregullisht mundësinë për rritje në kategori / gradë të çdo audituesi të interesua për zhvillim në karrierë, në një periudhë maksimale 3-vjeçare. Periodikisht audituesit ftohen publikisht të marrin pjesë në teste për ngritje në karrierë, e në vijim.

Formimi profesional realohet në vijimësi si pjesë e programit vjetor të trajnimit përfshin trajnimin në fushën e auditimit të performancës për një pjesë të madhe të ditë – trajnimeve. Grup fokus i trajnimeve mbi auditimet e performancës nuk janë vetëm stafi i emëruar në Departamentin

e Auditimit të Performancës por edhe pjesa tjetër e audituesve , duke krijuar kështu mundësi për rritje dhe zhvillim në drejtim të këtij lloj auditimi të gjithë strukturave audituese.

Statusi i implementimit : Realizuar në vijimësi

OBJEKTIVI NR. 4. ZHVILLIMI DHE KONSOLIDIMI I AUDITIMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE PËRDORIMI I TINËAUDITIM

Ky objektivi është detajuar në dy nën objektiva ai (4.1) Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të TI dhe (4.2) Zhvillimi i auditimit të TI. Nën objektivat 4.1 dhe 4.2 paraqiten si në vijim. KLSH shfaqet tashmë si një institucion avangardë që përdor teknikat vizualizuese në analizimin dhe identifikimin e zonave të riskut në përpunimin e BIG data. Institucioni ka përjetuar implantimin e teknikave CAAT, IDEA dhe konceptet e teknologjisë së informacionit po përdoren gjerësisht në procesin auditues në të gjithë departamentet e KLSH-së. Në funksion të zhvillimit të mëtejshëm, nën moton nga eksperiencia e përbashkët përfitojmë të gjithë, janë zhvilluar dy procese rishikimi mes kolegësh apo peer review, me Drejtorinë e IT të SAI homologë, procese që kanë përforcuar me tej punën audituese në këtë Drejtori. Gjatë vitit 2016 u planifikuan 3 auditime të teknologjisë së informacionit nga të cilat u realizuan 2 auditime dhe auditimi i tretë është në proces për tu përfunduar në vitin 2017. Në përfundim të auditimeve janë dhënë 34 rekomandime për përmirësim të situatës së konstatuar.

Auditimi i kryer në Agjencinë e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore ishte një Auditim Pilot i mbështetur nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAIT (IDI) i kryer pas trajnimit online një vjeçar. Në këtë fushë të auditimit, Drejtorja e Auditimit IT duke zbatuar Manualin e Auditimit të IT, teknikat CAATs, metoda vizualizuese ka arritur të evidentojë problematika të një dimensionit të ri të pa realizuar më parë në auditimet në KLSH.

Në Maj 2016 u zhvillua procesi i Vetë-Vlerësimit të Auditimit IT (ITASA) në KLSH, me Moderatorë nga Gjykata Evropiane e Auditorëve dhe nga Zyra Kombëtare Bullgare e Auditimit dhe Koordinatorin Lokal Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Qëllimi i kësaj ITASA është menaxhimi me një mprehtësi specifike të gjendjes së funksionit të Auditimit IT dhe pozicionimi i këtij auditimi me sfidat e të ardhmes. Kjo do të thotë, marrje në konsideratë të mandatit të Institucionit të Lartë të Auditimit, jetëgjatësinë dhe shumëllojshmërinë e projekteve IT në sektorët të qeverisjes, metodologjinë ekzistuese të auditimit TI si dhe kompetencat e stafit. Trajnimet në fushën e TI-së dhe Auditimit të TI-së do të jenë prioritet i lartë për vitet në vazhdim. Hartimi i një moduli trajnimi të veçantë në lidhje me TI ka filluar të kryhet duke u mbështetur nën projektin IPA në bashkëpunim me stafin e Drejtorisë së IT në vijim.

Nën-Objektivi 4.1: Zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të TI

Ndërkohë që shumë prej aktiviteteve të parashikuara për këtë nën objektivin 4.1 , të tilla si 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, janë realizuar plotësisht deri në periudhën e këtij Raporti mbeten ende në proces : Aktiviteti 4.1.4 “Krijimi i një Helpdesku për auditimet e IT-së” , për të cilin gjatë periudhës Janar - Shkurt 2017, janë realizuar analiza dhe zhvillimi i një moduli IT si dhe është kryer trajnimi i vijës së parë të helpdesk-ut në secilin departament.

Këto veprimtari do të ndiqen nga aktivitete plotësuese deri në përfundim të Projektit IPA, (mars 2018) me marrjen e produktit përfundimtar.

Aktiviteti lidhur me “Zhvillimin e një auditimi pilot të IT-së në një sistem tipik të IT-së së administratës shtetërore” është në proces. Pjesë e bashkëpunimit me ekspertët Polak janë

auditimet “Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, “APP”, “Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme Shoqërore”.

Nën-Objektivi 4.2: Zhvillimi i auditimit TI

Ky nën objektiv mbështetet nga aktiviteti 4.2.1 “Zhvillimi i metodologjisë për auditimin e teknologjisë së informacionit” është në proces realizimi. Manuali i Auditimit të IT është duke u rishikuar dhe vlerësuar me mbështetjen e asistencës teknike pjesë e projektit IPA, aktiviteti 2.4.1, duke e shoqëruar atë me auditime pilot.

Statusi i implementimit : Realizuar në vijimësi

OBJEKTIVI NR. 5. RITJA E KONTRIBUTIT TË KLSH PËR QEVERISJEN E MIRË, NËPËRMJET LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT

KLSH është vendosur në qendër të institucioneve përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit. Ndërmarrja e veprimeve kundër korrupsionit ka marrë dimensione të reja nga viti në vit.

Dedektimi dhe denoncimi i rasteve të korrupsionit në njësitë publike të audituara janë shoqëruar me masa konkrete për të luftuar korrupsionin si fenomen dhe jo thjesht si raste të identifikuara/ Nga ana tjetër organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere të iniciuara dhe realizuar që prej vitit 2012 enë vazhdim kane synuar të sjellin në vëmendje të publikut të gjerë dhe ligjvënësve se lufta kundër korrupsionit është përgjegjësi e të gjithëve dhe çdo qytetar përfiton nga kjo e fundit.

Forcimi i kapaciteteve audituese konsiderohet si jë strategji efektive për të mbështetur përmirësimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje si dhe për të sjellë impakt në jetën e qytetarëve. Një qeverisje efektive dhe e mirë krijojnë parakushtet për sukses në luftën ndaj korrupsionit dhe mashtrimit. Atje ku përgjegjshmëria dhe transparenca janë në nivele thuajse jo ekzistente mashtrimi dhe korrupsioni bëhen tipar karakterizues nënë sektorin publik.

Auditimet cilësore dhe vendosja e standardeve të larta në raportimin financiar janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm që sigurojnë në pakësimin e mundësisë së veprimeve mashtruese. Korrupsioni prek çdo qelizë institucionale dhe organizative, si individualisht ashtu dhe sistemet. Pasojat e një ambienti korruptiv ndjehen në shumë aspekte të jetës ekonomike e politike të vendit ndaj dhe lufta kundër tij kërkon kontributin e të gjitha palëve.

KLSH prej disa vjetësh po punon që të përsoset gjithnjë e më shumë në kërkim të strategjive efektive për të qenë të suksesshëm në luftën kundër korrupsionit. Në aspektin metodologjik Urdhri i Kryetarit numër 1, datë 13/01/2014 “Për Metodologjinë e Riskut” dhe më pas Urdhri numër 18, datë 12/02/2015 “Për ngritjen e Grupit të Punës që do të punojë për përpunimin e informacionit të marrë nga institucionet shtetërore për identifikimin e objekteve me risk ekonomik, financiar dhe shoqëror”, kanë vendosur bazat për të organizuar dhe orientuar luftën kundër korrupsionit në mënyrë efektive.

Si një metodë inovative e luftës kundër mashtrimit dhe korrupsionit bazuar në një metodologji balancuese të masave parandaluese dhe atë ndëshkimore KLSH ka përkthyer dhe botuar “Auditimin e integritetit”.

Lufta kundër mashtrimit dhe korrupsionit nëpërmjet auditimeve të KLSH njuh tregues konkretë të cilët kanë ardhur duke u përmirësuar nga viti në vit të tilla si intensifikimi i rasteve dhe rritje e numrit të kallëzimeve penale. Për vitin 2014, KLSH ka bere 41 kallëzime dhe për vitin 2015

KLSH ka bërë 51 kallëzime për 159 persona, Në përputhje me objektivin e tij strategjik të përmirësimit të qeverisjes, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit, institucioni gjatë vitit 2016, për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike, KLSH ka bërë 49 kallëzime penale ndaj 191 punonjësve publikë, kryesisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës.

Në bazë të planit të implementimit të Projektit IPA (aktiviteti 2.1.2) sipas parashikimeve ka filluar kryerja e trajnimeve me objekt auditimin e mashtrimit dhe korrupsionit dhe përfshirë sistemin e sinjalizuesve (Whistle blower) si një metodologji specifike në këtë fushë.

KLSH ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e organizuara nga SAI-t homologe apo dhe Institucionet Ndërkombëtare. Përmendim: Pjesëmarrja në seminarin e zhvilluar në datat 3-7 Mars 2014, në Hungari me temë “Praktikat më të mira ndërkombëtare në forcimin e integritetit në sektorin publik”, organizuar nga Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë për të mbështetur punën kundër korrupsionit të Institucioneve Supreme të Auditimit në vendet në zhvillim. Qëllimi i këtij seminary ishte që të rritej integriteti i institucioneve publike në vendet në zhvillim, të shpjegohej metodologjia e anketimit mbi integritetin e aplikuar gjatë këtyre viteve të fundit nga SAI Hungarez, si dhe të shkëmbeheshin eksperiencat e ndryshme.

Pjesëmarrja në Konferencën e organizuar nga Këshilli i Evropës Konferenca rajonale Ballkanike “Mbi zbulimin dhe investigimin e korrupsionit e mashtrimit publik procedurave të auditimit”. Pjesëmarrja në Kongresin Ndërkombëtar mbi prokurimin publik i organizuar në Slloveni 23-24 Prill 2015. Pjesëmarrja në Konferencën dhe seminarit mbi transparencën dhe integritetin 23-27 Mars 2015, Hungari. - Seminar për antikorrupsionin, 22-23 Shkurt 2016, Hungari.

Pjesëmarrja aktive në Task Forcë për rishikimin e ISSAI 30 dhe në hartimin e Udhëzuesit për Auditimin e Etikës në të cilin KLSH ofroi kontributet në një nivel me SAI-t e tjera anëtare të Grupit të Punës tregoi angazhimin tonë institucional për të qenë pjesë aktive në rrjetin e institucioneve antikorrupsion jo vetëm në nivel kombëtar por dhe në nivel ndërkombëtar. Në Qershor 2017, KLSH ishte institucioni pritës i tryezës së organizuar nga SIGMA “ Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit”

Prej Majit 2012 KLSH ka iniciuar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave. Për rivitalizimin e kësaj marrëveshje është parashikuar përditësim i i saj dhe për këtë qëllim është nxjerrë edhe urdhri i Kryetarit nr 51 dhe datë 30.04.2016. Kjo marrëveshje do të plotësohet, përditësohet me zhvillimet më të fundit në fushën e auditimit në vend dhe synon që në vitet që vijojnë në objektivat e saj kryesore, që janë sinergjizimi i luftës kundër dukurive të mashtrimit financiar e korrupsionit, shmangia e dublimeve në auditim dhe reduktimi i kostove. Institucioni, nëpërmjet ndihmës së auditimit të brendshëm do të zhvillojë një qasje unike auditimi, duke përdorur rezultatet e punës së këtij të fundit, nëse ajo është në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Auditimi i brendshëm mund të marrë raportet e auditimit të jashtëm (KLSH) dhe të kontrollojë se si Menaxhimi i ndjek rekomandimet, si dhe mund të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

KLSH do të inkurajojë audituesit e brendshëm që të vendosin theksin në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Ky inkurajim do të kryhet edhe përmes shkëmbimit të informacionit dhe programeve të auditimit

Në strategjinë e tij KLSH ka vendosur theksin në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve që janë dhënë në përgjigje të rasteve korruptive për ndëshkimin e shkeljeve flagrante të ligjit dhe përfitimeve në mënyrë të padrejtë nga përdorimi i fondeve publike.

Si dëshmi të vullnetit të saj për të luftuar anti-kulturën e pandëshkueshmërisë, KLSH vazhdon të intensifikoje përpjekjet për shtimin e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së administratës publike dhe për ta bërë KLSH *një pasqyrë transparente dhe profesionale ku të shihte veten, të identifikonte me përgjegjësi gabimet dhe të orientohej për korrigjimin e tyre, duke forcuar imazhin e saj në publik dhe rritur besimin e qytetarit ndaj qëllimeve, politikave dhe programeve të qeverisë.*

Ky objektivi është realizuar dhe vijon të realizohet në përputhje me objektivat e detajuara në planet vjetore.

Statusi i implementimit : Realizuar në vijimësi

OBJEKTIVI NR. 6 RRRITJA E NDIKIMIT PËRMES KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT

Strategjia afatmesme e zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2013-2017 (e rishikuar për vitet 2015-2017), në Objektivin 6 të saj “ *Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit*” i ka dhënë komunikimit një rëndësi parësore.

KLSH ka zbatuar elementë modernë të komunikimit dhe është duke hartuar draft strategjinë për komunikimin, në bashkëpunim me Institucionin Suprem të Auditimit (SAI) të Polonisë, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit mes të dy SAI-ve, IPA 2013 (financim i BE-së).

Strategjia e komunikimit, thekson marrëdhëniet e KLSH me publikun dhe Kuvendin, si dhe duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Mbështetja në median e shkruar dhe në kanalet mediatike të komunikimit ka reflektuar duke e bërë të ditur, punë e madhe audituese të kryer gjatë këtyre viteve nga institucioni. Ky tashmë përbën një standard të ri, i cili ka treguar se shton vlerë në auditimin e jashtëm publik në vend dhe në veçanti në auditimet e kryera nga KLSH. Transparenca dhe përgjegjshmëria institucionale ka arritur në nivelet më të larta të arritura, duke krijuar një aset të madh për institucionin e KLSH-së, aset që do të zhvillohet dhe fuqizohet më tej.

Kolana e botimeve të KLSH-se ka arritur në 50 tituj dhe përmbajta e këtyre botimeve është vërtet impresionues, si për larmishmërinë e temave, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit.

Kanë vijuar bashkëpunimin me ne për realizimin e Revistës personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, si Prof.Ass.Dr Recai Akyel, Zv/President i EUROSAT-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive; z. László DOMOKOS, President i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë, auditues nga SAI Kroat, nga Gjykata Gjermane e Auditimit, Prof. Dr Ilia Kristo, Prof. Dr Hysen Çela, Prof. Asoc Adriatik Kotorri, auditues të KLSH-së, etj KLSH ka kuptuar në kohë rëndësinë e komunikimit, duke hapur institucionin dhe duke rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij. Në fund të vitit 2016, KLSH ka qenë i pranishëm 6.7 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar dhe kemi gjashtëfishuar prezencën e institucionit në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010.

Gjatë vitit 2016, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp me një numër prej 931 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrejt 922 gjithsej përgjatë 2015.

Gazetarët u janë përgjigjur prononcimeve tona, problematikave të dala nga auditimet e ushtruara nga ana jonë dhe aktiviteteteve të ndryshme gjatë këtij viti. Po kështu, KLSH ka qenë prezent pothuajse në të gjitha gazetatat me 135 shkrime, të shkruara nga 72 auditues të KLSH-së. Gjate katër viteve, 2013-2016 audituesit e KLSH kanë botuar 396 artikuj.

Përgjatë vitit 2016 KLSH ka qenë prezente në 53 aktivitete të rëndësishme si Kongrese, Konferenca, Takime, seminare, trajnime, (këto të fundit edhe në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et homologe). Projekti i Binjakëzimit IPA “Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm”, me asistencën e NIK-ut polak dhe SAI-t Kroat ka çelur një horizont të ri në trajnimet e KLSH-së duke i konkretizuar njohuritë e përfituara në praktikë, nëpërmjet auditimeve të përbashkëta pilot. Ndër më të rëndësishmet përmendim pjesëmarrjet në:

- Takimet e Grupit të Punës të EUROSAT-t mbi Auditimin e Mjedisit (ËGEA);
- Kongresin e II-të të Prokurimeve Publike në Slloveni;
- Takimi i VII-të i Task Force së EUROSAT-t për Auditimin dhe Etikën
- Seminarin mbi Qasjen Audituese të Gjykatës Europiane të Audituesve, Luksemburg;
- Takimi i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Teknologjinë e Informacionit, Poloni;
- Trajnimet pranë Gjykatës Turke të Llogarive dhe NIK-ut polak;
- Seminarin e Institutit European për Administratën Publike mbi Prokurimin Publik dhe Koncesionet e BE-së;
- Ëorkshop-et PPAII, Auditim Paralel i Performancës në Prokurimin Publik;
- Konferenca e Programit SIGMA mbi “Marrëdhëniet SAI-Parlament”, etj.

